



SOS FSHATRAT
E FËMIJËVE
SHQIPËRI

RREGULLAT DHE KUSHTET E ANKANDIT

Shoqata SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri është një organizatë sociale, jo-politike dhe jo fetare, që ofron kujdes afatgjatë me bazë familjare për fëmijët, të cilët kanë humbur prindërit, apo që për arsye të ndryshme nuk mund të jetojnë me prindërit e tyre.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri mbështet gjithashtu fëmijët, të rinjtë dhe familjet në nevojë përmes projekteve, që synojnë zhvillimin e kapaciteteve të këtyre familjeve.

Shoqata SOS Fshatrat e Fëmijëve në Tiranë shet një makinë OPEL ZAFIRA nëpërmjet ankandit.

Ky ankand do të aktivizohet për një periudhë 3 javore, nga data:
28/10/2019 deri më 18/11/2019, ora 16:00.

Makina OPEL ZAFIRA do të shitet duke u bazuar në rregullat si më poshtë:

Në vijim gjendet një përshkrim i detajuar i makinës, gjendja aktuale, funksionaliteti si dhe foto.

Shoqata SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri nuk jep asnjë garanci për mjetin e publikuar në ankand. Makina do të shitet në gjendjen ekzistuese. Makina apo pjesë të saj nuk mund të kthehen apo të rimbursohen.

Në ankand mund të marrin pjesë të gjithë personat resident mbi moshën 18 vjeç, i/e aftë për të hyrë në marrëdhënie shitblerjeje, si dhe çdo operator ekonomik i interesuar që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Punonjësit e Shoqatës SOS Fshatrat e Fëmijëve dhe të afërmit e tyre nuk mund të marrin pjesë në ankandet e shpallur nga SOS Fshatrat e Fëmijëve.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Makina: Opel Zafira

Viti: 2000;

Vende: 6+1;

Karburanti: Naftë;

Fuqia Motorrike: 1995;

Kambio: Manuale;

Km: 214000 km;

Ngjyra Gri

Dyer: 5 Dyer

Ajër i kondicionuar,

Pajisjet e Sigurisë:

dy mbështetse koke aktive përpara, airbag për drejtuesin dhe pasagjerin, 5 dyer, rripa sigurimi përpara dhe prapa, frena me disk përpara, sistem frenimi ABS.

Pajisjet nga jashtë:

Goma me dimension 165/70/R14 SV

Mirëmbajtja: (vaj, filtra, ferrota), është kryer mirembajtje rutine.

E pajisur me leje qarkullimi.



**SOS FSHATRA
E FËMIJËVE
SHQIPËRI**

Siguracioni dhe taksat kanë përfunduar me 25.10.2019.

Problemi teknik: Kompresor kondicioneri, stopa freni, motorino-pinjon-bokulla, kokë paraleli Opel Astra 98-05 TWR;

NJOHJA ME GJENDJEN TEKNIKE TË MJETIT DHE FORMULARËT E OFERTËS

Të interesuarit për të parë makinën nga afër dhe për të marrë formularët e ofertës, duhet të dërgojnë një email me titull “shprehje interesi për blerje makine” në adresën: info@soskd.org.al, ose në mesazh në adresën e facebook: SOS Fshatrat e Femijeve Shqiperi, deri më datë **04 Nentor 2019**.

Ditët e hapura për të parë makinën do të jenë:

07, 08 dhe 11 NENTOR 2019, ORA 12:00 – 16:30 në adresën SOS Fshati i Fëmijëve, Rruga Hermann Gmenier nr. 5, Sauk, Tiranë.

DORËZIMI I OFERTAVE

Të interesuarit duhet të dërgojnë ofertën e blerjes në zarf të mbyllur jotransparent, me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar:

“OFERTË PËR BLERJEN E MAKINËS OPEL ZAFIRA”,

Deri më datën **19 Nentor 2019, ORA 16:00**

Në adresën:

SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri

Rruga Qemal Stafa, P 1, Ap 15

Tiranë, Shqipëri; Tel: + 355 44 536 901

Zarfi duhet të protokollohet pranë sekretarisë të Zyrave dhe Kompania/Individi duhet të sigurohet që kjo ofertë është protokolluar. Për të shmangur çdo paqartësi, kërkohet që përfaqësuesi i kompanisë/ individi të mos largohet pa marrë numrin e protokollit të ofertës.

Secili pjesëmarrës duhet të paraqesë brenda në zarf:

Në rastin e personave fizikë:

- Formularin e ofertës
- Formularin e të dhënave të ofertuesit
- Kopje të noterizuar të QKR

Në rastin e individëve:

- Formularin e ofertës
- Formularin e të dhënave të ofertuesit
- Kopje të noterizuar të kartës së identitetit / pashaportës

ÇMIMI FILLESTAR: Çmimi fillestar i ankandit është **125'000 lekë**.

KUSHTET E SHITJES SË MAKINËS: në vend dhe në gjendjen aktuale.

Organizatori i ankandit nuk merr përsipër asnjë shpenzim për shitjen e makinës përveç kostove që i takojnë në lidhjen e kontratës së shitblerjes.

FITUESI I ANKANDIT DO TË SHPALLET OFERTUESI ME ÇMIMIN MË TË LARTË.



RREGULLA PËR OFERTUESIT:

- Kandidatët blerës janë të detyruar të plotësojnë formatin bashkangjitur “**Shtojca 1**” për të dhënë ofertën e tyre. Ofertat e dërguara jo sipas këtij formati do të refuzohen si të papranueshme.
- Kandidatët blerës janë të detyruar të plotësojnë formatin bashkangjitur “**Shtojca 2**” për të dhënat dhe kontaktet e tyre.
- Në rast të personave individ, duhet të dorëzohet një fotokopje e noterizuar e kartës së identitetit/pashaportës
- Në rast të subjekteve fizikë apo juridikë, duhet të dorëzohet kopje e noterizuar e statusit në QKR.
- Të tre këto dokumenta duhet të jenë plotësuar me shtyp ose të shkruhen me bojë që nuk fshihet, në shqip si dhe të jenë të firmosur nga ofertuesi (dhe të vulosur në rast të subjekteve) të futur në zarf të mbyllur, me të dhënat:

“OFERTË PËR BLERJEN E MAKINËS OPEL ZAFIRA”

- Afati i dorëzimit: Deri më **19 Nentor 2019, ORA 16:00**
- Kandidatët blerës përballojnë kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Subjekti shitës nuk është përgjegjës për këto kosto.
- Një ofertues mund të dorëzojë vetëm një ofertë të vlefshme e cila qendron e pandryshuar për të gjithë periudhën e ankandit dhe është e vlefshme për 30 ditë. Në rastin e dorëzimit të më shumë se një oferte do të merret në konsiderate oferta më e lartë ndërsa oferta tjetër do të shpallet e pavlefshme.

VLERËSIMI

Oferta duhet të jepet në Lekë.

Cmimi fillestar është **125'000 Lekë**.

Fituesi i ankandit do të shpallet ofertuesi me cmimin më të lartë.

Pas mbylljes së ankandit, Komisioni i Vlerësimit i përcaktuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri do të vlerësojë ofertat si dhe do të përzgjedhë fitues ofertën më të lartë. Fituesi do të njoftohet brenda 3 ditësh.

Ky ankand mund të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

- 1- Me vendim të subjektit shitës, në çdo kohë, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës. Subjekti shitës në asnjë rast nuk është i detyruar të shpallë fituesin për një ankand.
- 2- Nëse në ankand nuk është paraqitur asnjë ofertë e vlefshme brenda afatit të përcaktuar.

Subjekti shitës nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve, që kanë paraqitur oferta, për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.


VEPRIMET E SHITBLERJES

Pas njoftimit si fitues, blerësi i përzgjedhur duhet të kryejë brenda 3 ditëve pagesën në llogarinë bankare të SOS Fshatrave të Fëmijëve Shqipëri, sipas specifikimeve që do t'i jepen. Me konfirmimin e pagesës në bankë, me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes, blerësi do të marrë makinën. SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri nuk është përgjegjëse për asnjë kosto të transportit të makinës as për ndonjë dëmtim që mund të ndodhë në transport.



SOS FSHATRA T
E FËMIJËVE
SHQIPËRI

Fotografi te makines Opel Zafira



Shtojca 1.

FORMULARI I OFERTËS PËR ANKAND

[Data _____]

Për: *SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, Rruga Qemal Stafa, P 1, Ap 15, Tiranë*

* * *

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit: **Shitje e një makine Opel Zafira**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, unë _____, të nënshkruarit, deklaroj/më se:

1. Kam shqyrtuar dokumentet e ankandit për këtë procedurë dhe pranoj, pa rezerva e përjashtime, kërkesat, afatet kohore dhe kushtet, e shprehura në këto dokumente;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [_____]; (*monedha dhe vlera e ofertës*)
3. Oferta jonë është e vlefshme për 30 ditë;
4. Bie dakord për të kryer të gjitha procedurat sipas rregullave të ankandit nëse shpalle fitues.

Përfaqësuesi i ofertuesit _____

Nënshkrimi _____

V ula _____

(*nëse është subjekt tregtar*)

Shtojca 2.

FORMULARI I TË DHËNAVE TË OFERTUESIT Për individë :

Emër Mbiemër	
Adresa	
Numri i telefonit	
E-mail	
Numri i kartës së identitetit:	

FORMULARI I TË DHËNAVE TË OFERTUESIT Për subjekte :

Për subjekte dhe organizata:	
Emri i organizatës /subjektit:	
NIPT:	
Vendim gjykate ose nr. regjistrimi QKR	
E-mail:	
Telefon:	
Faqja Zyrtare	
Personi i Kontaktit:	
Email dhe telefon i personit të kontaktit	